



Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Stabilitätspakt für Südosteuropa
Gefördert durch Deutschland
Stability Pact for South Eastern Europe
Sponsored by Germany

**Disa përfundime të dala nga anketimi i shtetasve dhe administratës
vendore mbi gjendjen e minoriteteve në qytetin e Korçës¹**
Material paraprak

- 1. Dy fjalë për Komitetin Shqiptar të Helsinkit**
- 2. Pse u ndërмор ky studim dhe çfarë synon të sjellë**
- 3. Metodologjia e përdorur**
- 4. Falenderime**
- 5. Disa përfundime të dala nga anketimi i shtetsatasve dhe administratës
vendore mbi gjendjen e minoriteteve në qytetin e Korçës**
- 6. Përfundime dhe sugjerime**

¹ Përpunimi i të dhënave dhe raporti mbi anketimet është shkruar nga Prof.as.dr Gjergj Sinani, profesor në Departamentin e Filozofisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. Ky material përmbledhës është bazuar në raportin e plotë të përgatitur nga eksperti dhe është përmbledhur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Anketimi dhe përgatija e këtij raporti është mundësuar me mbështetjen financiare të Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e këtij Fondacioni.

1. Dy fjalë për Komitetin Shqiptar të Helsinkit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, organizata e parë joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, është themeluar si Forumi për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut, dhe është regjistruar me vendimin nr. 17/1 të Ministrisë së Drejtësisë, datë 12.01.1991. Më 22 mars 1992, organizata u anëtarësua pranë Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me emërtimin Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Pas miratimit të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, KShH-ja u regjistrua pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të Tiranës në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Misioni kryesor i KShH-së është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, rivendosja e të drejtave të shkelura, ndërgjegjësimi i shtetasve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre dhe përmirësimi i legjislacionit dhe i praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave dhe rekomandimeve. Pjesë e këtij misioni është, gjithashtu, edhe rritja e përgjegjshmërisë së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të kësaj administrate.

2. Pse u ndërmor ky studim dhe çfarë synon të sjellë

Ratifikimi i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nga ana e Republikës së Shqipërisë në vitin 2000 shpreh jo vetëm vullnetin politik të Shqipërisë për të qenë pjesë e Europës së të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, por edhe një realitet i prekshëm që, historikisht, ka qenë karakterizuar nga fryma e bashkekzistencës dhe tolerancës.

Në kuadër të veprimtarisë së tij në fushën e minoriteteve, KSHH ndërmori nismën e zbatimit të projektit “Monitorimi i Ushtimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës” i cili u zbatua në Bashkinë e Korçës. Qëllimi i projektit është vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në këtë qytet, dhe evidentimi i mundësive për zhvillimin e tyre. Gjithashtu, nëpërmjet tij synohet të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në përgjithësi dhe e minoriteteve në veçanti, në vendimmarrjen vendore dhe të forcohen marrëdhëniet e tyre me pushtetin vendor.

Pjesë e kësaj nisme ishte realizimi i një anketimit të qytetarëve në Bashkinë e Korçës dhe administratës së Bashkisë Korçë. Nëpërmjet anketimit synohej të bëhej: vlerësimi i punës së bashkisë Korçë nga ana e qytetarëve; vet-vlerësim i punës së administratës bashkiake Korçë; evidentimi i shkallës së pjesëmarrjes së përfaqësuesve të minoriteteve në vendimmarrjen vendore; evidentimi i mundësive për përmirësimin e punës së administratës bashkiake në promovimin dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës.

Zbatimi i këtij projekti ishte pjesë e një nisme rajonale ku përveç Shqipërisë janë përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile në Maqedoni, Serbi, Rumani, Bullgari

3. Metodologjia e përdorur

Për realizimin e studimit është përdorur një metodologji e caktuar. Baza e saj ka qenë përgatitja e dy lloje pyetësorësh. Një pyetësor për qytetarët dhe një pyetësor për administratën e Bashkisë së Korçës.

Në këtë kuadër është realizuar anketimi i cili ka qenë në dy plane:

Së pari, në nivelin e qytetarëve. Në këtë nivel studimi synonte të nxirrte në pah perceptimin e banorëve të qytetit për problematikën minoritare.

Së dyti, në nivelin e administratës vendore. Në këtë nivel, studimi synonte të nxirrte në pah perceptimin e administratës vendore për problemin në fjalë. Meqënëse është studimi i parë i kësaj natyre, në aspektin që ndalet në nivelin vendor, studimi synon përshkrimin sa më të detajuar të problematikës së minoriteteve parë nën perspektivën horizontale dhe atë vertikale, pra të opinionit publik dhe atë institucional. Nën një perspektivë fenomenologjike, kuptimi i të qenurit kalon përmes përshkrimit sa më të imtë të të menduarit të aktorëve që janë bërë objekt studimi. Kështu që edhe paraqitja e rezultateve të studimit ka ndjekur logjikën e mësipërme.

Për realizimin e studimit janë intervistuar qytetarë të Korçës, përfaqësues të minoriteteve në Korçë, përfaqësues nga rrethet akademike dhe intelektuale, shoqëria civile që vepron në Korçë, shoqatat minoritare, etj.

Pjesë e rëndësishme e anketimit ka qenë edhe pjesëmarrja e administratës së Bashkisë së Korçës, pa të cilën studimi do të kishte dalë jo i plotë dhe i cinguar.

Anketimi është realizuar në qytetin e Korçës gjatë periudhës Qershor-Gusht 2006. Në anketim janë përfshirë 480 qytetarë dhe 35 punonjës të administratës së Bashkisë.

Në këtë material janë paraqitur disa nga përfundimet kryesore të dala nga përpunimi i anketimeve të realizuara me qytetarët e bashkisë së Korçës dhe punonjësit të administratës bashkiake.

4. Falenderime

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dëshiron t'u shprehë falenderimet e tij të gjithë aktorëve të përfshirë në realizimin e këtij studimi, qytetarëve të Korçës dhe veçanërisht Z. Robert Dano, Kryetar i Bashkisë Korçë, Z. Gjergji Mero, Kryetar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë, Z. Ermir Skënderi, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë, Prof.dr. Gjergji Pendavinji, Prof.as.dr. Gjergji Sinani dhe Znj. Keti Qirinxi, korrespondente e KSHH-së në Korçë.

Gjejmë rastin t'i shprehim falenderimet edhe Fondacionit "Friedrich Ebert Stiftung" për mbështetjen financiare në realizimin e këtij studimi.

5.1 Respektimi i të drejtave të minoriteteve në perceptimin qytetar

Respektimi i të drejtave të minoriteteve në nivel vendor. Pyetjes nëse të drejtat e minoriteteve respektohen në bashkinë e Korçës, 16% e qytetarëve të intervistuar i janë përgjigjur se respektohen plotësisht, 44% përgjigjen se respektohen pjesërisht, 36% përgjigjen se respektimi i tyre varet nga komuniteti dhe 1.8% thonë se të drejtat e minoriteteve nuk respektohen fare. Në përgjithësi niveli i respektimit të të drejtave të minoriteteve mund të konsiderohet e kënaqshme, por fakti se 36% përgjigjen se respektimi i të drejtave varet nga komuniteti ku bën pjesë, të bën të mendosh për trajtim të diferencuar preferencial për ndonjë minoritet.

Shërbimet që ofrohen nga bashkia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të minoriteteve. Lidhur me shërbimet që ofron bashkia e Korçës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të minoriteteve në këtë Bashki, nga intervistat ka rezultuar se qytetarët konsiderojnë si të tilla: përdorimin e gjuhës së minoriteteve në shkolla dhe falas, mbështetjen financiare, punësimin, strehimin, pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme, infrastrukturën, mbështetjen e aktiviteteve, sigurimin e të drejtave të barabarta ligjore, ofrimin e ndihmës ligjore etj. Ndër ta, ka një përqindje të konsiderueshme të qytetarëve të cilët nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Mundësitë e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga Bashkia nga minoritetet: Nga të dhënat e përpunuara rezulton se ekziston një diferencë ndërmjet perceptimit të shërbimeve dhe mundësive të realizimit të tyre. Në këtë kuadër 50% e të anketuarve janë shprehur se nuk i dinë shërbimet që ofrohen nga bashkiadhe se shërbimet përdoren pamjaftueshmërisht nga ana e minoriteteve. Në këtë situatë ngrihet problemi i efektivitetit të shërbimeve për personat që u përkasin minoriteteve.

Megjithatë, qytetarët janë shprehur pozitivisht për ndryshimin e situatës së respektimit të të drejtave të minoriteteve në vitet e fundit. 65% e tyre janë shprehur se situata e minoriteteve në Korçë ka ndryshuar pozitivisht, ndërsa 25% e tyre janë shprehur se situata ka mbetur e njëjtë gjatë viteve të fundit. Megjithatë, deri diku në kontradiktë me këtë të fundit, pyetjes se nëse ka patur raste të dhunimit të të drejtave të minoriteteve, 40% e qytetarëve janë shprehur për raste të dhunimit të minoriteteve, ndërsa 41% e tyre e kanë mohuar ekzistencën e dhunimit të të drejtave të minoriteteve.

Pyetjes se në cilat çështje që kanë të bëjnë me minoritetet do të kërkonit ndihmë, qytetarët kanë vlerësuar si një mjet shumë ndihmues për minoritetet, atë të punësimit, e më pas ndihmën ligjore, lëshim/marrjen e dokumentacionit, aksesin në informacion, etj. Fakti se nga 480 të anketuar 350 janë shprehur për punësimin dhe më pas për ndihmën ligjore, arrijmë në përfundimin se minoritetet kanë probleme sociale që karakterizojnë situatën tranzicionale në Korçë si dhe në tërë vendin. Gjithsesi, kjo situatë mund të ndihet më shumë te minoritetet dhe është e udhës që në kuadrin e politikave sociale të zbutjes së këtyre pasojave, t'i kushtohet një vëmendje e veçantë minoriteteve.

Roli i administratës publike. Përsa i përket vlerësimit që qytetarët i bëjnë rolit të administratës publike, nga përpunimi i të dhënave ka rezultuar se një pjesë e konsiderueshme e tyre e konsiderojnë jo shumë ndihmuese (31%), 38% ndonjëherë ndihmuese, 5% nuk e dinë dhe vetëm 22% e qytetarëve të anketuar e konsiderojnë rolin e administratës publike shumë ndihmuese.

Rekomandimet e qytetarëve për administratën e Bashkisë së Korçës: Lidhur me pyetjen nëse të anketuarit kanë rekomandime për administratën e bashkisë në lidhje me të drejtat e minoriteteve, qytetarët e anketuar bëjnë sugjerime të ndryshme për administratën e bashkisë Korçë. Mes tyre dallohen nevojat e marrjes së masave për punësimin, strehimin, mësimin në gjuhën e minoritetit dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve, sigurimi i përkrahjes sociale dhe ekonomike, etj. Fakti se rreth 140 anketuar nga 480 përgjigjen se nuk e dinë se çfarë t'i sygjeronjë bashkisë, ndoshta ka të bëjë me shkallën e njohjes së të drejtave të minoriteteve dhe se si duhet t'i mbrojnë ato.

Adresimi i qytetarëve në rastet e dhunimit të të drejtave të minoriteteve. Pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se në rastin e marrjes së informacionit se të drejtat e një personi që i përket një minoriteti po dhunohen, ata do t'i drejtohen organeve të policisë. Reagimi ndaj dhunimit të të drejtave të minoriteteve është një tregues i reagimit qytetar në një sistem demokratik. Gjithashtu është pozitiv fakti që qytetarët kanë besim te policia. Nga treguesit e paraqitur, pas policisë renditen organizatat ndërkombëtare dhe ato vendase, organet bashkiake. Ndërkohë, fenomeni që duhet përballur, si nga strukturat vendore dhe organizatat jo-qeveritare është ai i indiferencës së qytetarëve, pasi një numër i konsiderueshëm i të anketuarave janë përgjigjur se nuk do të bënin gjë në rastet e dhunimit të të drejtave të minoriteteve.

Përsa i përket rasteve se kur të anketuarit u janë drejtuar organeve të Bashkisë së Korçës për mbrojtjen e të drejtave të tyre, ka rezultuar se në 79% të rasteve qytetarët nuk u janë drejtuar organeve bashkiake, në 19% të rasteve u janë drejtuar organeve bashkiake, dhe 2% nuk e dinë.

Arsyet pse nuk i janë drejtuar bashkisë kanë qenë mungesa e besimit (38%), mungesa e eficientës (35%), nuk kanë kompetencat për të vepruar (12%) dhe se nuk kanë patur shkak për t'iu drejtuar (15%). Në këtë kuadër është e nevojshme që Bashkia të gjejë mjete dhe mënyra për të fituar besimin e qytetarëve.

Fenomeni i diskriminimit: Parandalimi i diskriminimit është një nga drejtimet kryesore të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe ai duhet të përbëjë një prioritet në punën e organeve të qeverisjes vendore dhe të aktorëve të tjerë politikë dhe të shoqërisë civile. Të pyetur për fenomenin e diskriminimit dhe trajtimin e minoriteteve nga ana e organeve bashkiake, sipas perceptimit të qytetarëve rezulton se minoritetet trajtohen në mënyrë të diferencuar. Në këtë kuadër, të anketuarit janë shprehur se përkatësia në një minoritet të caktuar lidhet me diskriminimin në punësim (56%), arsimim (39%) dhe diskriminimin nga ana e organeve të bashkisë. Ndërkohë që 29% të qytetarëve kanë pranuar ekzistencën e diskriminimit në punësim ndaj minoriteteve, 25%

të diskriminimit në arsim dhe 19% e tyre kanë pranuar ekzistencën e fenomenit të diskriminimit nga ana e organeve bashkiake.

Përsa i përket trajtimit të barabartë të qytetarëve minoritarë dhe jo-minoritarë rezulton se 43% e qytetarëve mendojnë se nuk ka trajtim të barabartë, 46% e tyre mendojnë se ka trajtim të barabartë, ndërsa 11% nuk e dinë.

Integrimi i minoriteteve: Një nga treguesit e rëndësishëm të gjendjes së minoriteteve është edhe shkalla e integrimit të tyre në shoqëri. Nga anketimet e realizuara ka rezultuar se nga 480 të anketuar, mbi 200 prej tyre përgjigjen se janë marrë masa për integrimin e minoriteteve, 60 përgjigjen jo. Fakti se rreth 170 të anketuar përgjigjen se nuk e dinë, tregon se duhen zbatuar politika më publike.

Media: Në integrimin e minoriteteve një rol të madh luan media. Roli i medias në promovimin e tolerancës dhe pluralizmit kulturor është faktor i rëndësishëm për krijimin e një klime të harmonisë dhe tolerancës ndëretnike. Pyetjes nëse media lokale promovon tolerancën dhe pluralizmin kulturor 55% e të anketuarve i janë përgjigjur pozitivisht dhe 23% negativisht. Nisur nga fakti se 22% përgjigjen se nuk e dinë, shtron një problem në median lokale për një organizim më të mirë të aspektit të përmbajtjes së saj.

Niveli i informimit nga ana e medias për qëndrimet e administratës vendore ndaj minoriteteve është një tregues i rëndësishëm i ndikimit të saj në promovimin e vlerave të demokracisë, dhe, në një kontekst më të ngushtë, i trajtimit të minoriteteve. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë shprehur se rrallë, media ka raportuar raste kur administrata bashkiake ka kryer veprime për të mbështetur të drejtat e minoriteteve ose për të evidentuar shkeljet e të drejtave të tyre, ndërkohë që 24% e tyre janë shprehur se nuk e dinë, 13% e tyre janë shprehur që kjo gjë ndodh shpesh dhe 10% e tyre janë shprehur se kjo gjë nuk ndodh kurrë.

Problemi është shqetësues kur bëhet fjalë për mënyrën se si e paraqet media lokale situatën e të drejtave të minoriteteve. Rreth 240 të anketuar janë shprehur se media e paraqet në mënyrë jo objektive ose shumë të njëanshme situatën e të drejtave të minoriteteve, ndërsa rreth 130 të anketuar janë shprehur se media bën një pasqyrim objektiv të situatës së të drejtave të minoriteteve. Nga ana tjetër, në vijim, të anketuarit kanë vlerësuar televizionin si mjetin mediatik më të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve (49%) e më pas vijnë gazetat, radioja dhe në fund interneti.

Përfaqësimi i minoriteteve: Të drejtat e minoriteteve janë në një raport të ngushtë me nivelin e përfaqësimit. Ky përfundim del edhe nga analiza e shifrave të dala nga anketimi ku 88% mendojnë se të drejtat e minoriteteve do të zbatoheshin më mirë në rast se përfaqësimi i minoriteteve do të ishte më i mirë.

Disa nga rekomandimet që të anketuarit i kanë drejtuar administratës së bashkisë së Korçës janë:

- Punësimi (85)

- Të jepet më shumë mundësi shkollim në gjuhën e tyre (65)
- Sigurimi i ndihmës ekonomike, sociale dhe shëndetësore (50)
- Të sigurohet strehim (45)
- Të tregojnë interes më të madh ndaj minoriteteve (39)
- Të ketë zbatim të ligjit në mënyrë të barabartë (39)
- Të mos ketë diskriminim (20)
- Të ketë përfaqësim më të gjerë të minoriteteve në administratën publike
- Të punojnë më mirë për integrimin e minoriteteve (18)
- Të respektojnë të drejtat e minoriteteve (18)
- Rregullimi i infrastrukturës (15)
- Të shtohen investimet dhe fondet (12)
- Të jenë të paanshëm (8)
- Nuk e di (150)

Të anketuarit kanë vlerësuar se punësimi, strehimi, shkollimi dhe arsimimi në gjuhën amtare, pjesëmarrja në administratë do t'i shërbente përmirësimit të gjendjes së të drejtave të njeriut.

5.2 Perceptimi i situatës së minoriteteve nga administrata e Bashkisë Korçë

Minoritetet si komunitet me të drejta të veçanta: Përgjigja ndaj pyetjes nëse minoritetet duhet të kenë/kanë nevojë për të drejta të veçanta për mbrojtjen e tyre dëshmon një moment të rëndësishëm të perceptimit të të drejtave të minoriteteve nga ana e administratës së Bashkisë Korçë në raport me mazhorancën e popullsisë. Në konceptimin europian minoritetet, për faktin se janë minoritete, duhet të gëzojnë disa të drejta të veçanta në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Duhet theksuar se ky është edhe tregues i rëndësishëm i nivelit të demokracisë që ekziston në një vend. Fakti që 57% e të intervistuarve mendojnë se minoritetet nuk duhet të kenë të drejta të veçanta për mbrojtjen e tyre dëshmon për një konceptim të ngushtë të problemit. Ndërkohë që 25% e të anketuarve janë shprehur se minoritetet duhet të kenë nevojë për të drejta të veçanta për mbrojtjen e tyre dhe 18% janë shprehur se kjo mbrojtje e veçantë duhet të jetë vetëm në disa fusha.

Shërbimet që ofron bashkia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të minoriteteve. Në përgjigje të kësaj pyetje të intervistuarit nga administrata përgjigjen se shërbimet më të shpeshta që ofrohen janë strehimi, punësimi, shkollimi, ndihma social-ekonomike, shërbimet publike, etj. Vlen të përmendet që një përqindje e lartë e të anketuarve nuk kanë dijeni për këto shërbime.

Një ndër pyetjet e drejtuara është niveli i përdorimit të këtyre mundësive nga ana e minoriteteve. Ajo që e vlerëson rolin e administratës është niveli i përdorimit të këtyre mundësive nga ana e minoriteteve. E përkthyer në shifra, kjo situatë paraqitet si më poshtë: 48% e të anketuarve përgjigjen se këto mundësi nuk përdoren shumë shpesh, 25% shpesh, 8,5% pamjaftueshmërisht dhe 18,5% nuk e dinë. Kjo tablllo tregon se situata mund të përshkruhet në mënyrë hipotetike. Fakti që 48% e të anketuarve përgjigjen se këto mundësi nuk përdoren shpesh tregon se ose minoritetet nuk janë të interesuar, ose

mungon informacioni për këto mundësi. Megjithatë ka një përmirësim progresiv të situatës e cila reflektohet në faktin që 66% e të anketuarave janë shprehur se situata e përdorimit të këtyre mundësive është përmirësuar gjatë viteve të fundit, ndërsa 23% e tyre janë shprehur se situata ka mbetur e njëjtë.

Rastet kur anëtarët e minoriteteve i kërkojnë ndihmë bashkisë për të drejtat e tyre. Nga të anketuarit ka rezultuar se rastet më të shpeshta kur anëtarë të minoriteteve i janë drejtuar Bashkisë së Korçës kanë qenë për rastet e diskriminimit në punë, aksesin në informacion, ndihmë ligjore dhe marrja e dokumentave. Në këtë kuadër, mendojmë se punësimi dhe e drejta e informimit duhet të përbëjnë dy prioritetet më të rëndësishme të punës së bashkisë Korçë.

Perceptimi i mundësive për integrim. Perceptimi nga ana e nëpunësve të Bashkisë së Korçës i mundësive për integrim të minoriteteve fokusohet në dy çështje: arsimimin fakultativ shumëkulturore në shkollë (62%) dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore (35%). Mendojmë se problemet e integritit janë shumë më të gjera. Arsimimi dhe kultura janë dy komponentë të rëndësishëm jo vetëm të identitetit kulturor, por edhe të komunikimit dhe të respektit reciprok. Megjithatë duhet një vizion më i gjerë i integritit që duhet të përfshijë edhe aspekte të tjera si qarkullimi ekonomik, arti, feja etj.

Problematike paraqitet situata kur bëhet fjalë për shërbimet përtej detyrimeve ligjore që ofron bashkia. Në këtë kuadër, në përgjigje të pyetjes se “çfarë shërbimesh përtej detyrimeve ligjore ekzistuese ofron bashkia, seksioni/drejtoria juaj”, nga anketimet ka rezultuar se një numër i madh nëpunësish përgjigjen se nuk e dinë çfarë shërbimesh përtej detyrimeve ligjore ekzistuese ofron bashkia, seksioni/drejtoria përkatëse. Pavarësisht se ka një përzjerje të detyrave funksionale me ato jashtë funksionit, nga larmia e përgjigjeve vihet re ka një përpjekje për një funksion më social të nëpunësve.

Përdorimi i dokumenteve për të drejtat e minoriteteve në punën e përditshme të administratës. Nga anketimi i administratës publike, pjesa dërrmuese e të anketuarve janë shprehur se përdorin dokumentet për të drejtat e minoriteteve vetëm në raste të caktuara (42%), ndërkohë që 20% e tyre janë shprehur se nuk i përdorin kurrë këto dokumenta.

Megjithëse, nuk është e specifikuar, mendojmë se Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare duhet të zërë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë konkrete të nëpunësve të bashkisë. Në qoftë se do të mbledhim grupin e përgjigjeve “shumë rrallë”, “kurrë” dhe “nuk e di”, që përbëjnë 49% të totalit mendojmë se konteksti evropian dhe ai rajonal duhet të zënë një vend të rëndësishëm në trajnimin e nëpunësve lokalë, në funksion të përmirësimit të marrëdhënieve horizontale (ndërmjet minoriteteve), por edhe atyre vertikale (ndërmjet komuniteteve dhe përfaqësuesve vendorë).

Kjo nevojë trajnuese përforcohet edhe nga përgjigjet që dalin rreth pyetjes mbi dobinë e trajnimeve për të drejtat e minoriteteve ku 89% e të anketuarve e konsiderojnë të dobishëm një trajnim të tillë.

Marrëdhëniet ndërmjet pushtetit qendror dhe vendor në lidhje me të drejtat e minoriteteve. Lidhur me çështjen e ndërhyrjes ose problemeve me pushtetin qendror në lidhje me të drejtat e minoriteteve, janë mbajtur qëndrime të ndryshme ku 32% e të anketuarve janë shprehur se nuk ka patur kurrë probleme/ndërhyrje nga pushtetit qendror, 29% janë shprehur ndonjëherë, 23% janë shprehur rrallë dhe 16% nuk e dinë.

Fenomeni i diskriminimit. Përsa i përket diskriminimit të personave që u përkasin minoriteteve nga ana e punonjësve të bashkisë, nga përgjigjet e mëposhtme rezultojnë situatë pozitive (80% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk ka patur), por në qoftë se do ta ballafaqojmë me përgjigjet e pyetjes në lidhje me rastet e shkeljes dhe, konkretisht, në cilat fusha, vihet re se një përqindje e lartë e tyre ka pranuar diskriminimin në punë dhe arsim, e më pak në gjuhë dhe strehim, ndërkohë që një përqindje e vogël është shprehur se nuk ka raste të diskriminimit.

Nisur nga një interpretim tërësor i të dhënave të anketave, mendojmë se mos-penalizimi i ndonjë anëtarit të administratës publike nuk është pasojë vetëm e marrëdhënieve të mira ndërmjet administratës publike dhe minoriteteve, por edhe e faktit se përfaqësuesit e minoriteteve nuk janë të informuar për shkeljet ndaj tyre dhe mjetet që mund të përdoren për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Arsimimi. Një nga të drejtat që Konventa Kuadër u njeh minoriteteve është e drejta e arsimimit në gjuhën e minoritetit që i përkasin. Nga përgjigjet e dhëna nga të anketuarit e administratës publike vihet re një lloj paqartësie për këtë problem. Fakti që 22.5% i përgjigjen jo pyetjes “nëse kanë të drejtë anëtarët e minoriteteve që të përdorin në shkollë gjuhën e minoritetit të cilit i përkasin” dhe 17.5% përgjigjen se nuk e dinë, dëshmon se ndihet nevoja për kuptimin e drejtë të kërkesave të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Këtë paqartësi e provojnë edhe rezultatet në lidhje me ushtrimin e kësaj të drejte, ku 40% e të anketuarve janë shprehur se këtë të drejtë e ushtrojnë vetëm disa minoritete, 32% e tyre janë shprehur se kjo e drejtë ushtrohet nga anëtarët e minoriteteve etnike, 11% e tyre janë shprehur negativisht (jo), ndërsa 17% nuk e dinë.

Problemi i arsimimit të minoriteteve dhe i braktisjes së shkollës duhet të përbëjë një shqetësim të autoriteteve vendore, ku, sidomos braktisja e shkollës, përbën një problem shqetësues. Lidhur me këtë problem është i nevojshëm një angazhim më i madh nga ana e administratës vendore për të gjetur rrugët dhe mjetet e zbutjes së problemit. Rezultatet sipas të cilave 56% e të anketuarve janë shprehur se bashkia ka marrë masa plotësues për të parandaluar braktisjen e shkollës nga anëtarët e komuniteteve, flasin për nevojën e një angazhimi më të madh.

Integrimi i minoriteteve. Problemi i integrimit të minoriteteve duhet të përbëjë një nga drejtimit themelore të administratës vendore. Siç del nga përgjigjet, mundësitë e integrimit të minoriteteve shihen në shumë fusha, por si prioritare vlerësohen arsimimi dhe ndihma ekonomike sociale e madje janë këto dy fusha ku bashkia ka përqëndruar punën e saj për integrimin e minoriteteve, e më pak kulturë e sport, punësim, etj. Megjithatë vlen të theksohet se problemi i integrimit duhet të ketë vision më të gjerë.

Përsa i përket ushtrimit të mundësive për integrim nga anëtarët e minoriteteve, të anketuarit janë shprehur se kjo e drejtë ushtrohet (58%), 35% e tyre janë shprehur se kjo e drejtë ushtrohet ndonjëherë dhe 7% janë shprehur se kjo e drejtë nuk ushtrohet.

Informimi. Për sa i përket informimit për qytetarët, pyetjes se cilat janë mekanizmat për dhënien e informacionit për qytetarët në bashkinë e Korçës, të intervistuarit kanë përcaktuar si mekanizma kryesorë gazetën e bashkisë, drejtoritë dhe zyrat e informacionit, gazetat dhe televizioni. Një vend më të vogël zënë takimet ditore, shpalljet e vendimeve, interneti, fletëpalosjet etj. Kur bëhet fjalë për raste të pengesave për marrjen e informacionit 68% e të anketuarve janë shprehur se nuk ka raste të pengesave, ndërsa 37% e tyre janë shprehur se ka shumë pak raste. Më tej, të anketuarit nga administrata e bashkisë janë shprehur se anëtarët e minoriteteve e ushtrojnë të drejtën për marrjen e informacionit (79%), 7% janë përgjigjur negativisht dhe 14% nuk e dinë.

Përfaqësimi i minoriteteve. Problemi i përfaqësimit të minoriteteve në strukturat përfaqësuese vendore është një tregues i rëndësishëm i nivelit të demokracisë. Nga anketimi pothuajse të gjithë bien dakort se përfaqësimi i minoriteteve në këshillin bashkiak do të ndikonte më mirë në zbatimin e të drejtave të tyre. Një gjë e tillë është pranuar nga 70% e të anketuarve, ndërsa 12% janë shprehur se nëse përfaqësimi i minoriteteve në këshillin bashkiak do të ishte më i gjerë, nuk do të ndikonte për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve.

Për sa i përket mekanizmave ekzistues për përfaqësimin e minoriteteve, vihet re një paqartësi e madhe e kuptimit praktik të mekanizmave të përfaqësimit. Ashtu sikurse edhe në shumë çështje të tjera, numri i nëpunësve që përgjigjen se nuk e dinë, është i lartë. Pjesa dërrmuese e të anketurave kanë cilësuar si mekanizëm për përfaqësimin e minoriteteve në këshillin bashkiak, pjesëmarrjen e lirë në mbledhjet e këshillit bashkiak.

Komunikimi me administratën. Komunikimi i anëtarëve të minoriteteve me administratën në gjuhën e tyre është një e drejtë që u njeh Konventa minoriteteve. Sigurisht këtu është fjala në ato njësi vendore ku përbërja minoritare është e lartë. Nga rezultatet vihet re se 70% e të anketurave i përgjigjen negativisht pyetjes nëse minoritetet kanë të drejtë t'i drejtohen administratës në gjuhën e tyre. Ky është tregues i nivelit të ulët të njohurive mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe kushtet e ushtrimit të kësaj të drejte. Paqartësinë e tregojnë edhe fushat se ku mendojnë se duhet të ushtrohet kjo e drejtë, ku vihet re numri i madh i atyre që përgjigjen se nuk e dinë.

Kjo paqartësi shihet edhe në një varg çështjesh duke filluar nga njohja e legjislacionit mbi shenjat topografike në nivel vendor, ndarja e kompetencave ndërmjet nivelit vendor, rajonal dhe kombëtar si dhe fushat ku nuk është zbatuar në mënyrë të mjaftueshme. Ajo që vihet re është përsëri numri i lartë i atyre që përgjigjen se nuk e dinë.

Po kështu paraqitet gjendja edhe në lidhje me sugjerimet për problemin e përcaktimit të kompetencave të ndërmjet nivelit vendor, rajonal dhe kombëtar.

Gjendja ndryshon kur bëhet fjalë për sugjerimet që janë dhënë nga të anketuarit për përmirësimin e situatës së të drejtave të minoriteteve. Përsa i përket të drejtës së informimit, nga sugjerimet e të anketuarve, shihet domosdoshmëria e një buletini për çështjet e minoriteteve, kontakte më të mira me qytetarët, politika për një bashki të hapur dhe masa normative. Në lidhje me masat konkrete për të përmirësuar përdorimin e gjuhës të anëtarëve të minoriteteve të bën përshtypje kërkesa për zbatimin më të mirë të ligjeve.

Edhe për sa i përket hapave që propozohen për përmirësimin e të drejtave të minoriteteve në nivel vendor, bie në sy kërkesa për zbatimin rigoroz të ligjeve si dhe nevoja e trajnimeve për të dy aktorët, minoritetet dhe administratë vendore.

Edhe për sa i përket mundësive konkrete për integrimin e mëtejshëm të minoriteteve theksohen arsimimi fakultativ shumëkulturore dhe organizimi i aktiviteteve kulturore të përbashkëta.

Për parandalimin e diskriminimit të anëtarëve të minoriteteve theksohen trajnimi i administratës publike dhe ndryshimi i legjislacioni penal, ku të vendosen si rrethana rënduese kryerja e veprave penale për shkak të përkatësisë etnike.

Në sugjerimet për përmirësimin e situatës së minoriteteve në fushën e arsimit vihet re krijimi i mundësive të barabarta për të gjitha grupet e minoriteteve, hartimi i projekteve për çështjet e arsimit dhe një vlerësim i plotë i situatës arsimore të minoriteteve.

Në masat konkrete për përmirësimin e integritetit të minoriteteve theksohen bashkëpunimi me grupet e komuniteteve përkatëse, organizimi i aktiviteteve publike për promovimin e kulturës dhe vlerave të tjera të minoriteteve dhe gjuha zyrtare. Ndoshta, te kjo e fundit shihet nevoja e forcimit të njohjes së gjuhës zyrtare në funksion të një integrimi më të mirë të minoriteteve, pasi duke e vënë theksin te mësimi i gjuhës minoritare, shpesh harrohet mësimi i gjuhës zyrtare që është po aq i domosdoshëm për integrimin e minoriteteve me popullsinë tjetër.

Me interes janë edhe sugjerimet për përmirësimin e përfaqësimit të minoriteteve etnike ku theksohen; krijimi i sektorëve të veçantë për çështjet e minoriteteve, komitet këshillues i përbërë nga anëtarë të minoriteteve, vende të rezervuara në këshillin bashkiak.

6. Përfundime dhe sugjerime

1. Veprimtaria e aktorëve politikë në nivel vendor duhet t'i kushtojë një vëmendje më të madhe njohjes së problematikës së minoriteteve në funksion të njohjes së të drejtave të tyre në përputhje me parametrat e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe të krijimit të kushteve për zbatimin e tyre. Në këtë perspektivë është i rëndësishëm zbatimi i parimit të barazisë në trajtimin e minoriteteve. Kjo përforcohet nga fakti i përgjigjeve për problemet e mësipërme ku në përgjigje mbizotëron shqetësimi në trajtimin sipas minoriteteve.

2. Është një fenomen shqetësues fakti i mosbesimit të qytetarëve ndaj organeve të administratës vendore për t'iu drejtuar në rast të shkeljes së të drejtave të minoriteteve. Në këtë kuadër është e nevojshme që Bashkia e Korçës të punojë më shumë dhe të gjendet më pranë qytetarëve me qëllim që të fitojë besueshmërinë e saj ndaj qytetarëve.
3. Nisur nga anketimet e qytetarëve, punësimi, strehimi, arsimiti etj, vlerësoheshin si problemet kryesore sociale. Në këtë kuadër është e nevojshme që ato të jenë objekt i një pune të kujdeshme në funksion të krijimit të harmonisë dhe paqes sociale.
4. E drejta e informimit duhet të shikohet në dy aspekte: së pari në funksion të qytetarëve që u përkasin minoriteteve dhe, së dyti, në funksion të paraqitjes së rezultateve pozitive të punës së administratës vendore.
5. Një vend të veçantë duhet të zënë programet dhe strategjitë e të gjithë aktorëve politikë e socialë në luftën ndaj fenomenit të diskriminimit, si një premisë e rrezikshme në cënimin e paqes sociale.
6. Autoritetet vendore duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë politikave arsimore dhe kulturore, siç del edhe nga shumë rekomandime të qytetarëve dhe punonjësve të administratës, në funksion të njohjes reciproke dhe të integritetit të minoriteteve.
7. Është e rëndësishme nxjerrja në pah dhe njohja e dokumentacionit që i përket problematikës së minoriteteve. Në këtë perspektivë, është e domosdoshme që të qartësohen detyrat dhe kompetencat ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor në trajtimin e problemeve të minoriteteve. Kjo do t'i shërbente efektivitetit të punës.
8. Siç del edhe nga sugjerimet e administratës publike është i domosdoshëm trajnimi i kësaj administrate me problematikën e minoriteteve. Në këtë drejtim njohja e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe mekanizmit të saj do t'i shërbente qartësimin të shumë problemeve që kanë të bëjnë me arsimin, pjesëmarrjen, përdorimin e gjuhës etj.
9. Është i domosdoshëm hartimi i një strategjie të përbashkët të të gjithë aktorëve të interesuar në luftën kundër stereotipeve negative ndaj minoriteteve. Kjo është e rëndësishme sepse aty ndodhen në embrion farat e urrejtjes, intolerancës dhe diskriminimit.
10. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar problemit të romëve dhe egjiptianëve si komunitetet më të prekura nga tranzicioni dhe paragjykimet.